

FJALA E DEPUTETIT **FATMIR MEDIU**

21 MARS 2024

Të nderuar kolegë deputetë,

Baza e këtij Parlamenti, e çdo demokracie, është vota e lirë. Dhunimi që i bëhet votës së lirë, mosgarantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, dominimi i interesave politike dhe klanore në çdo proces zgjedhor ka bërë që të kemi një deformim të jashtëzakonshëm edhe në debatin tonë politik, edhe në qëllimet tona politike.

Pa dyshim, fati i Komisionit të Reformës Zgjedhore u paracaktua që në datën 21 shtator, kur mazhoranca votoi se cila është opozita dhe si duhet drejtuar komisioni, duke shmangur atë që ishte në thelb marrëveshja me OSBE-në, që në vitet 2002-2003, gjithëpërfshirje dhe bashkëkryesim me të drejtën e vetos, ndërmjet pozitës dhe opozitës. Dhe fati dihet, kur qëndrimet janë të njëanshme dhe politike. Nuk është shakaja e fundit, por është shakaja që bëhet për më shumë se 2 vjet në mosfunksionimin e këtij komisioni. Duket se nga opinionet që hidhen s'ka, as më shumë dhe as më pak, po të njëjtin qëndrim. Atëherë, çfarë pengon për ta bërë reformën zgjedhore? Bazuar mbi marrëveshjen e dakordësuar me OSBE-në, së pari, ne duhet të rikthejmë mundësinë e koalicioneve parazgjedhore, si një mundësi për të zhvilluar pluralizmin, jo vetëm për grupe të caktuara politike, por për çdo forcë të re politike.

E dyta, që është e domosdoshme, të kthejmë kushtetutshmërinë në Parlament. Qytetarët votojnë deputetët nëpërmjet listave të hapura. E treta, të mos qajmë sot për vitin 2008, por të kishim mend edhe në vitin 2008 kur e bëmë. Të mos flasim vetëm sot për listat e hapura, por sa herë kishim nevojë, ta bënim prej vitesh me radhë. Për më tepër, diaspora e di më mirë se kushdo tjetër si duhet të votojë dhe çfarë duhet të bëjë për çdo lloj drafti që sjell një palë apo një tjetër. Ata e kanë paraqitur versionin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë, ne si deputetë vetëm e kemi mbështetur.

Për më tepër, të nderuar kolegë deputetë, e rëndësishme është që kush i vjedh zgjedhjet, kush i intimidon votuesit, duhet të përgjigjet si deputet apo si parti politike përballë ligjit. Ne nuk mund të qeverisemi nga deputetë apo qeverisje që burojnë nga këta deputetë, të cilët kanë vjedhur apo kanë intimiduar në procesin zgjedhor. Prandaj, është e domosdoshme që konsensusin për reformën zgjedhore ta shikojmë si element primar të domosdoshëm, për ta kthyer Parlamentin në binarët kushtetues, për të pasur diaspora të drejtën e votës dhe për të zhvilluar pluralizmin në Shqipëri.